



Pranuar / Dërguar Punjenor/Prodato Received/Delivered	12.07.2023	3	viti god Year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	SKP/SHCK	5163/2023	116
Hi Prof Bi Prof Prof No		Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.792/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.792/2023 të datës 29.05.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga kundër Vendimit me Nr.1138 të datës 0.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 12.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr.1138 i datës 05.05.2023 i Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës.
- II. OBLIGOHET Komisioni Disiplinor në Inspektoratin të Punës, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rishqyrtimin e lëndës për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit
- III. OBLIGOHET Menaxheri i Burimeve Njerëzore, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, t’i ndërmerr të gjitha veprimet administrative për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Akt Emërimit IP nr.57/2017 të datës 06.03.2017 në pozitën *Menaxher i IT*, më datë 28.03.2023 Drejtoresha e Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshëm si mbikëqyrëse e drejtpërdrejt e ankuesit, ka parashtruar kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor me arsyetimin se “... e njëjta ka vlerësuar se ankuesi ka bere shkelte te rendë dhe ne kuptim te paragrafit 6 te nenit 7 te Rregullores (QRK) me numër NR.11/2020 kërkon nga komisionit disiplinore që të fillohet procedura disiplinore ndaj [] pasi që ndaj zyrtarit në fjalë tashme është konsumuar masa disiplinore vërejtje me shkrim, dhe [] në vazhdimësi nuk ka respektuar orarin e punës në kuptim të asaj që ka bërë mungesa të shumta në vendin e tij të punës, gjate gjithë vitit 2022, mungesat i ka bërë në mënyrë të përsëritur në shumë raste zyrtare në fjale ka pretenduar se mungesat janë si shkak i gjendjes shëndetësore, por që për kundër të njëjtit i është dhënë mundësia të prezantoj shenjat e mjekut i njëjti nuk ka arritur te prezantoj këto dëshmi pra për 13 dite nuk ka shenja mjekësore....”.

Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës më datë 05.05.2023 ka nxjerr Vendimi me Nr.IP1138 përmes të cilit ankuesin e ka shpall përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore “*ndalim i 40% i pagës për një periudhe deri në gjashtë muaj*”.

Ankuesi kundër Vendimit me numër 1138 të datës 05.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, më datë 29.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4504/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.06.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Inspektorati i Punës. Ndërsa Këshilli më datë 20.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4504/2023 të datës 29.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Dokumentin mjekësor të datës 04.05.2022; Emalin e datës 07.05.2023 të drejtuar [] Procesverbalin e datës 05.05.2023 të Komisionit Disiplinore; Shkresën mjekësore të datës 01.02.2022; Shkresën mjekësore lidhur me rezultatin për virusin COVID; Emalin e datës 03.03.2022 të drejtuar [] Emalin e datës 26.04.2022 të drejtuar [] Certifikatën e datës 08.06.2022 lidhur me pjesëmarrjen e trajnimit “ *Të drejtat dhe Detyruat e Zyrtareve Publike dhe Kodi i Mirësjelljes*”; Shkresën mjekësore të datës 13.05.2022; Raportin mjekësore 04,05,2022; Vendimin për pushim mjekësore të datës 15.07.2022; Vendimin për pushim mjekësore të datës 08.11.2022; Emalin e datës 02.08.2022 të drejtuar [] Emalin e datës 01..08.2022 të drejtuar [] Emalin e datës 11.08.2022 të drejtuar [] Emalin e datës 10.20.2022 të drejtuar [] Emalin e datës [] drejtuar [] e datës [] drejtuar [] Emalin e datës 11.011.2022 të drejtuar [] drejtuar []

Emalin e datës 14.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 18.01.2022 të drejtuar Emalin e datës 05.12.2022 të drejtuar

29.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 13.12.2022 të drejtuar Emalin e datës 05.12.2022 të drejtuar

Emalin e datës 14.12.2022 të drejtuar Emalin e datës 13.12.2022 të drejtuar

05.12.2022 të drejtuar Emalin e datës 05.12.2022 të drejtuar shkresën mjekësore të datës 04.05.2022; Shkresën mjekësore të datës 06.12.2022; Flete lëshimin e datës 21.12.2022 deri me datën 27.12.2022; Vendimin për pushim të datës 17.01.2023; Vendimin me numër të protokollit 1138 të datës 05.05.2023 të Komisionit Disiplinore; Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin të vendimit me numër 878/2020 të datës 14.10.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 23.01.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 02.06.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 20.06.2023; Vendimin me numër 202/2022 të datës 19.07.2022 të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; Emalin e datës 17.01.2023 të drejtuar

Emalin e datës 17.01.2023 të drejtuar Kërkesën për hapjen e procedurës disiplinore të datës 05.04.2023; Emalin e datës drejtuar Emalin e datës 27.03.2023 të drejtuar

Emalin e datës 29.04.2022 të drejtuar Emalin e datës 04.07.2022 të drejtuar Emalin e datës 04.07.2022 të drejtuar Emalin e datës 04.07.2022 të DMZP-së; Emalin e datës 15.07.2022 të drejtuar Akt emërimin me numër të proktollit 57/2017 të datës 06.03.2017; Vendimin me numër 06.03.2017 për korrigjonin e gabimeve të akt emërimit të Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës të datës 13.01.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës të datës 04.01.2022; Vërejtjen me shkrim me numër të proktollit 1240 të datës 07.10.2021; Emalin e datës 02.05.2023 të drejtuar Emalin e datës 04.05.2023 të drejtuar

Evidenca e hyrje-dalje ne pune për datën 18-janar.2022; Evidenca për hyrje-dalje për datën 02.02.2022; Evidenca për hyrje- dalje në punë për datën 03.02.2022; Evidenca për hyrje dalje në punës për datën 04.02.2022; Evidenca për hyrje dalje në punës 07.02.2022; Evidenca për hyrje dalje në punës për datën 08.02.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 09.02.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 02.03.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 03.03.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 28.03.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 29.03.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 26.04.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 27.04.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 27.04.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 28.04.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 11.05.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 12.05.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 13.05.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 10.05.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 06.05.2022; Evidenca për hyrje dalje ne pune për datën 05.05.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 04.05.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 05.07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 06..07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 07.07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 08.07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 14.07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 15.07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 27.07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 18.08.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 17.08.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 16.08.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 15.08.2022;

Komisioni disiplinor nuk ka vepruar ne pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse me rastin e shqiptimit të masës disiplinore: " *I ndalohet 40% e pagës për periudhën kohore deri në gjashtë (6) muaj*", nuk ka arritur të përcaktoj saktë periudhën kohore, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore.

Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor masën disiplinore e ka shqiptuar në kundërshtim me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L - 114, për Zyrtaret Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 13 paragrafin 13 te Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, sepse Komisioni Disiplinor ka dështuar që të caktoj kohëzgjatjen e masës disiplinore, pasi që ka dhënë masën "*...deri në gjashtë muaj (6)*", dhe nuk ka përcaktuar afatin e saktë të kohëzgjatjes se për sa muaj saktësisht vlen kjo masë respektivisht kjo ndalesë e pagës, duke lënë kështu të hapur periudhën e ndalesës së pagës e që është në kundërshtim me dispozitën e ligjit.

Me dispozitat e nenit 47 të Ligjit Nr. 06/L - 114, për Zyrtaret Publik të Republikës së Kosovës, kjo masë disiplinore është përcaktuar si në vijim : „ *1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj*; duke e lënë në diskrecionin e komisionit disiplinor që në varësi të shkëljes dhe provave të bashkëngjitura të përcaktoj saktë përqindjen e ndalesës dhe periudhën e masës disiplinore brenda përqindjes maksimale *deri në 40% e pagës* dhe afatit maksimal të kohëzgjatjes që është prej *deri në gjashtë (6) muaj*.

Tutje Kolegji i Këshillit po ashtu ka gjetur se Komisioni Disiplinor në Inspektoratin e Punës me rastin e marrjes së vendimit me numër 1138 të datës 05.05.2023 nuk kane arritur të konstatojnë drejte gjendjen faktike sepse ne shkresa të lëndës të dërguara nga vet organi i punësimit Kolegji ka gjetur se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë me date 28.03.2023, ndërsa komisioni disiplinor konstaton se inicimi disiplinor ndaj ankuesit është marr me date 31.01.2022, po ashtu data e nxjerrjes se Vendimit te Komisionit Disiplinor eshtre 19.04.2022, ndërsa ky vendim është i protokolluar me datë 05.05.2023.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu pasi ka shqyrtuar dosjen e lëndës, ka konstatuar masa e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor nuk është shqiptuar në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil.

Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit të lëndës, është i obliguar që të vlerësoj të gjitha provat e bashkëngjitura të lëndës, duke marrë parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese, gjithashtu për ankuesin të vendos për shqiptimin e masës disiplinore ne proporcion me shkëljen e kryer, në pajtim me nenin 50 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës, si dhe te caktoj sakte përqindjen dhe kohëzgjatjen e masës disiplinore në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Duke qenë së vendimi i kundërshtuar me ankesë është përfshirë me shkëlje të dispozitave procedurale të cilat e bëjnë të paligjshëm një akt administrativ, Kolegji i Këshillit nuk u lëshua në konstatimin e pretendimeve materiale, kështu që me qëllim të kthimit të ligjshmërisë e ne pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin


1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që ankesa e ankuesit të kthehet në rishqyrtim tek Komisioni Disiplinore në Inspektoratin e Punës.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.792/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Inspektoratin e Punës;
- Komisionit Disiplinor në Inspektoratin e Punës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.